



SHLUIJ "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"

Republika e Shqipërisë
SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti"
Tiranë

Nr. 2976 prot



Republika e Shqipërisë
Universiteti "Ismail Qemali"
Vlorë

Nr. 607 prot

**Marrëveshje për Realizimin e Programit të Përbashkët
Bachelor në Edukim Fizik e Sporte**

E lidhur sot, në Mare, më datën 12. 02. 2020, ndërmjet palëve :

ShLUIJ " Universiteti Marin Barleti "
përfaqësuar nga Rektori
Prof. Dr. Marenglen Spiro

dhe

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
përfaqësuar nga Rektori
Prof. Dr. Roland Zisi

Kjo marrëveshje miratohet nga Senatet Akademike të dy Institucioneve të Arsimit të Lartë përkatëse, të cilat bien dakord për sa më poshtë.

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo marrëveshje merr shkas nga Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Neni 3 gërma c, Neni 80 dhe udhëzimi Nr. 1, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", kreu IV/ A, pika 6.

**Neni 2.
Qëllimi i marrëveshjes**

Programi i përbashkët "Edukim Fizik e Sport", (më poshtë EFS), realizohet me bashkëpunimin e strukturave përkatëse të dy universiteteve, Departamenti i Edukimit Fizik e Sportit i ShLUIJ " Universiteti Marin Barleti" (Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit) të SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti" dhe Departamenti i Edukimit (Fakulteti i Shkencave Humane) të Universitetit "Ismail Qemali".

Institucionet bien dakord të ngrenë një Bord të Përbashkët të Menaxhimit dhe kujdesit për zhvillimin e proceseve të programit sipas rregullores së tij dhe të secilit institucion; ky Bord përbëhet nga përgjegjësit e njësive përkatëse kryesore dhe bazë të të dy institucioneve.

Neni 3.

Angazhimi i SHLUJ “Marin Barleti” dhe Universitetit “Ismail Qemali”

Programi i Studimit për EFS është autorësi e ShLUJ “Universiteti Marin Barleti”, është i akredituar dhe, aktualisht, në funksionim në UMB. Palët nënshkruese bien dakord të ngrihet, në përputhje me modalitetet e miratuara, si një program i dytë i tillë, me veçantinë që të jetë i përbashkët dhe me dhënie të diplome të përbashkët.

Programi i Përbashkët i studimit do të ketë një rregullore funksionimi të miratuar nga Senatet.

Neni 4.

Angazhimi për mbulimin e programit të studimit

Programi i EFS do të mbulohet në masën të paktën 70% me pedagogë të brendshëm, pjestarë të personelit akademik të brendshëm të të dy institucioneve. Lëndët e shkencave shoqërore do të mbulohen nga pedagogë të brendshëm të Universitetit “Ismail Qemali”. Nëse Universiteti “Ismail Qemali” nuk ka mundësi të mbulojë këto lëndë me pedagogë, ato mbulohen nga pedagogë të SHLUJ “Marin Barleti”.

Lëndët sportive dhe ato mjekësore do të realizohen nga pedagogë të brendshëm të SHLUJ “Marin Barleti”.

Pedagogët e jashtëm, në masën e lejuar, do të përzgjidhen nga komisione të përbashkëta dhe do të miratohen sipas rregullave të secilit institucion.

Neni 5.

Ngarkesat e pedagogëve

Ngarkesat e pedagogëve të brendshëm të angazhuar në këtë program nga secili institucion, llogariten bazuar në kriteret e institucionit përkatës.

Universiteti “Ismail Qemali” paguan pedagogët e tij të brendshëm që cakton për realizimin e lëndëve të programit.

ShLUJ “Universiteti Marin Barleti” paguan pedagogët e tij të brendshëm që cakton për realizimin e lëndëve të programit si dhe pedagogët e jashtëm të programit.

Pedagogët e jashtëm do të paguhën mbi bazë marrëveshje bilaterale.



Neni 6.
Realizimi i programit të studimit

Programi do të realizohet në ambjentet e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë. Për lëndë që duhen zhvilluar në ambjente që nuk i disponon Universiteti "Ismail Qemali", është detyrë e tij që të sigurojë këto ambjente. Një kopje e dokumenteve të administruara i kalon online (në rrugë elektronike) Sekretarisë Mësimore qendrore të ShLUJ "Universiteti Marin Barleti" brenda 48 orëve nga realizimi.

Neni 7.
Efektet financiare

Tarifa e ndjekjes së Programit të Përbashkët EFS do të përcaktohet në përputhje me rregullat financiare, duke respektuar vendimet dikasteriale përkatëse në çdo rast.

Studenti paguan tarifat e shkollimit në llogaritë të cilat do të rekomandohen.

Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në dy kopje me vlerë të njëjtë, duke marrë nga një të tillë secila palë.

Për ShLUJ "Universiteti Marin Barleti"

Raktori
Prof. Dr. Marenglen Spiro



Për Universitetin "Ismail Qemali"

Raktori
Prof. Dr. Roland Zasi

